REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 130/17
Datë/Datum. 01.06.17
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH Nr. 130/17

PANELI SHQYRTUES I PROKURIMIT, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: z.Goran Milenković - Kryetar, z.Nuhi Paçarizi - Referues, - z.Blerim Dina Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga OE ankues "Astraplan"- Prishtinë, kundër vendimit per dhënie të kontrates të AK– /Ministria e Puneve te Brendshme/, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Ndertimi i aneks objektit te Agjencise se Kosoves per Forenzike –Faza II" me nr. prokurimi:"214/16/052/521", më datën 29.05.2017 mori këtë:

VENDIM

I. **Aprovohet,** pjeserisht e bazuar ankesa e OE "Astraplan" - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndertimi i aneks objektit te Agjencise se Kosoves per Forenzike – Faza II" me nr prok:" 214/16/052/521", iniciuar nga autoriteti kontraktues /Ministria e Puneve te Brendshme/.

II. **Anulohet,** vendimi për dhënie të kontrates i AK-së /Ministria e Puneve te Brendshme/, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndertimi i aneks objektit te Agjencise se Kosoves per Forenzike –Faza II" me nr. prokurimit:" 214/16/052/521" si i pa bazuar dhe lënda kthehet ne **Rivlerësim**.

III. Autoriteti kontraktues në afat prej 10 ditësh, duhet ta informojë me shkrim Panelin shqyrtues, për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit dhe palët tjera në procedurë.

IV. Operatorit ekonomik ankues OE ""Astraplan" - Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndertimi i aneks objektit te Agjencise se Kosoves per Forenzike –Faza II" me nr prok:" 214/16/052/521" konform nenit 118.3 të LPP-së i kthehet tarifa e sigurimit të ankesës në shumë e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, pasi që ankesa është aprovuar si e bazuar.

V. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 36 pika 5 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Autoriteti Kontraktues-MPB ka bërë shpalljen e Njoftimit për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit me dt: 07.11.2016.

Dorëzimi dhe Hapja e ofertave është bërë me dt: 29.11.2016, ku kanë marr pjesë pese operatorë ekonomik.

AK-MPB me dt. 30.03.2017, ka caktuar komisionin për vlerësimin e tenderëve në përbërje prej 3(tre) antarëve te cilet kanë filluar dhe mbaruar vlerësimin me dt.04.04.2017.

Njoftimi për dhënje te kontrates lidhur me aktivitetit të prokurimit në fjalë është bërë me dt:14.04.2017, e ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik "Mercom Company" - Prishtine.

Kundër njoftimit për dhënje te kontrates lidhur me aktivitetin e prokurimit ne fjalë, operatori ekonomik "Astraplan" - Prishtinë, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik "Astraplan" - Prishtinë, për rishqyrtim të njoftimit për dhënje te kontrates Autoriteti Kontraktues me dt:20.04.2017 ka marr vendim me te cilin ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim.

Operatori ekonomik "Astraplan" - Prishtinë, si palë e pakënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, më dt.28 prill 2017 me nr. 130/17, kundër njoftimit për dhënie të kontratës me titull: "Ndertimi i aneks objektit te Agjencise se Kosoves per Forenzike –Faza II" me nr prok:" 214/16/052/521", duke pretenduar se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje esenciale të dispozitës së LPP-së nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, me Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, siç janë:

- Neni 7 i LPP-së –Barazia ne Trajtim/Jo-diskriminim
- Neni 55 i LPP-së –Menyrat e Komunikimit
- Neni 56 i LPP-së – Dispozitat e Pergjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesemarresve dhe Dhënien e

Kontratave

- Neni 59 i LPP-së – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve
- Neni 64 i LPP-së- Deshmite e Kerkesave
- Neni 65, Pika 4.3dhe 4.8 i LPP-së
- Neni 66 i LPP-së- Pershtatshmeria Profesionale
- Neni 55 i LPP-së- Dokumentacioni dhe informacioni shtese
- Neni 39.8 te RRUOPP

Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 të LPP-së, me dt.03.05.2017 ka autorizuar ekspertin e OSHP-së, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.
Eksperti shqyrtues përmes raportit të datës 12 maj 2017, propozon panelit shqyrtues që aktiviteti i prokurimit me titull "Ndertimi i aneks objektit te Agjencise se Kosoves per Forenzike –Faza II" me nr prok:" 214/16/052/521", të kthehet në Rivlerësim, ndërsa ankesen e operatorit ekonomik "Astraplan" - Prishtinë të aprovojë si pjeserisht të bazuar.
Autoriteti Kontraktues me datë: 16 maj 2017, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 23.05.2017, ku kanë qenë prezent anëtarët e panelit shqyrtues, eksperti shqyrtues, përfaqësuesit e palëve në procedurë, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënien e kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues "Astraplan" z.Istrefi ka deklaruar se:
Pas njfotimit të AK dhe njoftimit për dhënje të kotnratës kofnrom LPP kemi kërkuar qasje pranë AK-së.
AK na ka ofruar qasje konfrom LPP-së dhe nga të gjeturat në qasje për dokumente kemi bërë kërkesë sipas nenit 108A pranë AK për rishqyrtimin e vendimit për aktivitetin e prokurimit "**Ndërtimi i aneks objektit të Agjencisë së Kosovës për Forenzikë – Faza II**", me numër të prokurimit 214/16052/521.

Konform afateve ligjore AK na kthen përgjigje me vendim mbi refuzimin e kërkesës tonë si të pabazuar.
Pas kësaj kemi parashtruar ankesë në OSHP me pretendime se AK ka bërë shkelje të LPP-së dhe atë nenit 7, 56, 55, 58, 59, 64, 65, 65 pika 4.3 dhe 4.8, 66, 69, 72 të LPP-së si dhe nenin 39.8 të UOPP-së.
Në vazhdim do cekim të gejturat nga qasja dhe për secilin OE veq e veq dhe vetëm për këtë shkak jemi pajtuar me rekoamndimin përfundimtar të ekspertit për rivlerësim.

Kosntatimi 1 dhe 2 në ekspertizë eksperti është pajtuar me pikat e ankesës tonë mirëpo në par.3 të kosntatimit 2 gjatë elaborimit të nenit 41, bie në kundërshtim me nenin 41 dhe shtatë parimet kryesore të vlerësimit sipas LPP-së.
Në par.1 të nenit 41 edhe eksperti ka cek se "kur AK rivlerëson procedurën e prokruimti në mënyrë që të korrigjoj vendimet e gabusheme dhe një vlerësim bëhet si rezultat i një vendimi të OSHP-ës përfshirë një urdhër për rivlerësim, një vendim për rivlerësim të përzgjedhejs së ofertusve ose dhënies së kotnratës nuk nënkupton një ndryshim mbi rezutlatin fillestar". Që do thotë se OE i rekomanduar për kontratë dhe OE tjetër Evropa Partners shpk& ABC kanë qenë të papërgjegjshëm nga vlerësimi i parë dhe ky nen nuk nënkutpon që gjatë rivlerësimit këta dy OE nga AK ti nxjerr si të përejgjshëm edhe pse nuk kanë pltëosuar ksuhtet dhe kërkesat e dosejs së tenderit.
Po ashtu eksperti thotë se oferta e Evropa Partners është nënshkruar nga një pejsëmarrës në hapje, mirëpo nuk evidenton dëshminë se nuk ka qenë e nënshrkaur nga OE ofertues, që është në kudnërshtim me nenin 58 të LPP-së.
Rrjedhimisht ky konzorcium nuk ka të nënshrkuar e as të vulosur as paramasën e as formularin e tenderit pjesën 2, që në bazë të nenit 58 pika 3 të Ligjit 04/L-42 për prokurim publik i ndryshuar dhe plotësuar me 04/L-234 dhe 05L-068 dhe 05/L-092 nenin 58.3.

Nga qasja dhe dëshmitë e gjetura kemi vërejtë se jemi OE i vetëm që pltoësojmë kërkesat dhe kushtet e dosjes.
AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 59 të LPP par.4.
Rrjedhimisht OE i rekomanduar për kotnratë dhe OE Evropa Partners kanë dështuar të përmbushin kriteret konform, kërkesës së FDT dhe dosjes së ternderit.
Dokumentet e preznatuara nga OE konform përshtatshmërisë profesioanle të OE-ve para shpalljes fitues nuk i plotësojnë kërkesat e nenit 65 po ashtu edhe të dosejs së tenderit, ku kërkohet dokument nga ATK se nuk është në obligime së paku tre muaj para dorëzimit të tenderit.
Në dokumentin e dorëzuar OE i rekomanduar për kontratë fillimisht ka dorëzuar një dokument që është në kundërshtim me kërkesën e dosjes dhe është i periudhës pas rivlerësimit të ofertave nga ana e AK-së, që do thotë se nuk ka të plotësuar kërkesën kryesor të përshtatshmërisë profesionale.
Gjithashtu në dosje të tenderit në pikën 6.4, saktësisht ceket se në rast dëshmit të dorëzimit të këtij dokumenti tenderi do refuzohet, me qka AK ka vepruar në kundërshtim me këtë pikë.
Neni 65 saktësisht pika 4, e cakton se cilët OE mund të shpërblehen me kontrata pubike dhe pika 4.3 e këtij neni thuhet se OE-të që do shpërblehet me kontratë nuk kanë te drejt të kenë asnjë obligim në ATK as marrveshje për shlyerje të borxhit.
I ofroj panelit me shkrim fjalën tonë përfundimtare lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
I propozojmë panelit që të aprovoj ankesën tonë si të bazuar dhe lënda të kthehet në Rivlerësim, dhe duke u bazuar në shkresën e dorëzuar dhe të gjeturat në qasje në dokumebnte dhe dosje dy OE-të Mercom dhe Evropa të diskualifikohen të papërgjegjshëm, dhe AK të bëjë rivlerësimin kofnrom dosjes dhe FDT.

Gjatë prezantimit në seancë në vazhdim fjala iu dha përfaqësuesit të AK-MPB z.Thaqi cili deklaroj:
Ne si AK – MPB qëndrojmë pranë vlerësimit të komisionit vlerëues dhe njoftimit për dhënie të kontratës, sepse komisioni në rivlerësim ka zbatuar vendimet e OSHP-së, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë ka plotësuar kërkesat dhe kushtet me njoftimin për kontratë dhe dosje të tenderit.
Kemi shqyrtuar se vërtetimi i ATK është në përputhje me atë qka është kërkuar, ka një marrveshje dhe këtë e ka pranuar vet ATK, dhe për ne është dokument i vlefshëm.

Sa i përket OE Evropa Partners, i njëjti ka plotësuar dhe nënshkruar formularin e tenderit si kërkohet me LPP bile ndoshta edhe më tepër, i nënshkruar nga anëtarët e komisionit hapjes, nga OE.
Andaj qëndrojmë pranë vlerësimit tonë për dhënje të kontratës OE të rekomanduar për kontratë, dhe rekomandojmë që ankesa e OE të refuzohet si e pabazuar.

Në vazhdim fjala iu dha ekspertit shqyrtues z.Bibaj i cili deklaroj:
Arsyeja pse kamë propozuar që të shkoj lënda në rivlerësim ka të bëjë me kërkesën e pikës 6.1 poziocioni B i FDT-së, kërkesa për vërtetimin tatimorë. AK nga ofertuesit ka kërkuar që ofertuesit nuk duhet të jenë me vonesë për pagim të tatimeve së paku deri në tre mujorin e fundit para datës së publikimit të njoftmit për kontratë.
Vërtetimi i ofruar nga OE i rekomanduar për kontratë, pas rivlerësimit të ofertave përmban datën me vulë protokolli 04.04.2017, me përshkrimin se i njëjti OE aktualisht ka marrveshje për shlyerjen e borxheve me këste, për borxhet e mbetura. Po ashtu edhe përshklrimi që i njëjti vërtetim ka validitet 90 ditë.
Andaj kam rekomanduar që sipas nenit 72 të rikërkohet vërtetimi i njëjtë për periudhën kohore siq e ka kërkuar AK në dosje të ternderit, 90 ditë para njoftimit për kontratë, e njoftimi për kontratë në KRPP është publikuar me 07.11.2016.
OE ankuse ka edhe pretendime tjera që kam shqyrtuar dhe janë pjesë e raportit, rrjedhimisht edhe kam rekomanduar që ankesa e tij të aprovohet si pjesërisht e bazuar.

Anëtari i panelit z.Pacarizi pyeti ekspertin se vërtetimi a është pas rivlerësimit.
Në përgjigjje z.Bibaj dekalroj: kjo ka qenë kërkesë për OE fitues, e jo kërkesë për kuaklifikim.Kërkesa ka qenë që të jetë 90 ditë para njofitimit për kontratë.

Në vazhdim fjala iu dha përfaqësuesit të Mercom Company z.Elshani i cili deklaroj:
Ne kemi ofruar dy vëretime, në dosje qëndrojnë edhe kopjet e mbyllura, ne kemi vërtetimin e parë të ATK që nuk jemi me vonesë, i pari i datës 11 2016, po ashtu vërtetimi i dytë i cili thotë se kemi marrëveshje.
Nga KRPP ka interpretim ku thuhet se mund të nënshkruhen kontrata me vërtetim të tillë.
Duhet ti referohem neni 4 pika 26 ku thuhet "duhet të ketë interes juridik". OE ankuese është i pesti me rend për nga cmimi, është OE më i shtrenjtë, ndërsa ne jemi OE më i liri.
Ne kemi dëshmi prej OE ankues Astraplan ku në regjistrimin e firmës ka një punëtor, këtë dëshmi nga ARB ja ofroj panelit shqyrtues si dëshmi.
Neni 13 thotë se mund të komunikohet edhe në gjuhën angleze dhe kemi pas komunikim me YAHOO në gjuhë angleze dhe kemi ofruar vërtetim në gjuhë angleze.
Për ne është e papranueshme që OE më i shtrenjtë të ankohet për OE më të lirë.
Ne kemi vërtetim të ATK për vitin e kaluar, dhe po ashtu kemi vërtetim të këtij viti ku kemi marrveshje për pagesë me këste.
Me vendim të OSHP është kërkuar rishqyrtim, dhe në rishqyrtim kemi sqaruar me AK dhe kemi sqaruar edhe qështjen e emailit.

Anëtari i panelit z.Pacarizi pyeti përfaqësuesin e OE ankues se a keni atakuar gjithë OE tjerë.
Në pëgjigje z.Istrefi deklaroj: Tenderi vlerësohet sipas kërkesave të dosjes dhe LPP-së.
LPP saktësisht neni 65 pika 4.3 thotë "ofertuesit nuk kanë të drejtë të shpërblehen me kotnrata publike në rast se aktualisht ka një marrveshje ose aranzhim me kreditorët e tij që siguron kushte të zgjeruara

ose të reduktuara të pagimit nëse mbi kushtet e tilla janë pajtuar paraprakisht kreditorët e tillë, për shkak se OE më parë ka qenë i paaftë të përmbush obligimet e tij në afatin e duhur lgijor.
Kjo është se OE i rekomanduar ka qenë i vonuar në pagesën e tatimit, dhe tenderit dhe LPP dhe OE i përgjegjshëm konsiderohet kur plotësohen kushte sipas LPP e jo ATK.
As intepretimi i KRPP, në cilin nen mbështetet KRPP kur thotë se lejohet një marrveshje e tillë.
Sa i përket bazës në ARBK, ato shënime janë të vitit 2007, dhe nuk kërkohet me asnjë ligj të bëhet përditësimi apo Update, sa her që të është nevoja.
Ne përfundimisht kemi plotësuar gjitha kërkesat e FDT dhe dosjes së tenderit, dhe nuk është e rëndësishme a jemi më i i liri apo më i shtrjeti në rast se OE tjerë të papërgjegjshëm, ne jemi brenda buxhetit të AK dhe jemi OE i vetëm i përgjegjshëm me cmimin më të lirë.
OE Olti Trasing ka qenë më i shtrejtë mirëpo është disualifikuar në fazën e parë.

Sa i përket gjuhës angleze, ne sqarojmë se rregulorja e punë së OSHP nr.02/2015 si dhe 01/2017, pika 1 dhge 2 thuhet në pikën 1"gjuhë zyrtare të OSHP-së janë gjuha Shqipe dhe Gjuha Serbe". Neni 2 thotë "palët në procedurë të shqyrtimit do të prezantojnë përkthimin e certifikuar në gjuhë shqipe ose serbe të qdo dokumenti të gjuhëve të huaja që kosiderohet i rëndërësihëm për marrje të vendimit".
Kërkoj që sipas mundësive të sillet letra e prezanataur në seancën e kaluar nga YAHOO pasi kemi dyshime, dhe oferta e OE Evproa se është panënshkruar dhe pa vulosur.
I propozojmë panelit të aprovohet ankesa e jonë si e bazuar dhe lënda të khehet në Rivlerësim.

Anëtari i panelit z.Dina pyeti përfaqësuesin e AK se a keni zbatuar vendimin e OSHP për këtë lëndë dhe a qëndron pretendimi i OE ankues se OE nuk ka pas vëretim të ATK-së .
Në përgjigje z.Thaqi dekarloj: OE i rekomanduar ka marrveshje me ATK për pagim me këste dhe është më i vlefshëm pasi pasqyron gjendejn momentale të OE

Për emailin e kontestuar se nuk i janë dërguar, komisioni ka kosntatuar gjendjen sipas dokuemtacionit pas vendimit të OSHP dhe ka ardh te vendimi i tillë për rekomandim të OE për dhënje të kontratës. Nuk jamë në dijeni a e kanë vërtetuar emalin.

Paneli shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pikave pretenduese të parashtruesit të ankesës, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues të cekur në ekspertizë, parashtresës së AK-së, deklarimit te OE ankuese ne seancë lidhur me ekspertizën, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, konstaton se AK-MPB me rastin e rivlerësimit te ofertave lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndertimi i aneks objektit te Agjencise se Kosoves per Forenzike –Faza II" me nr prok:" 214/16/052/521" nuk i ka respektuar nenin 59 të LPP-së. Pasi që OE i rekomanduar për Kontrate është i pa përgjegjshëm sepse ka dorëzuar vërtetimin tatimor nga ATK me borxhe Neni 65 pika 4 e LPP-se thotë : *Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik- (4.8) aktualisht është me vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social apo tatim në Kosovë.* Por OE i rekomanduar për kontrate ka marrëveshje me ATK-ne për shlyerjen e borxheve dhe marrëveshja është pas dorëzimit te ofertave pranë Autoritetit Kontraktues.

Sa i përket pretendimeve te OE ankues për Konzorciumin e Operatoreve Ekonomik "europa partners dhe ABC", paneli shqyrtues vlerëson se qëndron pretendimi ankimor dhe se ky konzorcium eshte i pa përgjegjshëm pasi qe ky konzorcium nuk e ka dorëzuar asnjë reference për ndërtime te ndonjë objekti

por vetëm i ka dorëzuar dy raporte për ndërtimin e dy rrugëve pra nuk ka dorëzuar asnjë reference te ndërtimit te ndonjë objekti te njëjte apo te ngjashëm.

Prandaj Paneli shqyrtues, duke u bazuar në nenin 117 të LPP-së, si dhe duke u mbështetur në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .

Kryesuesi i Paneli Shqyrtues

Z. Goran MILENKOVIĆ

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – "Ministria e Puneve te Brendshme"

1x1 OE – "Astraplan" - Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së

1x1 Për publikim në ëeb- faqe të OSHP-së.